

Ndarësi i shoqërive dhe bashkësive-vdekja

Vdekja është ajo e cila çdo herë është afër njeriut madje edhe më afër se lidhëzat e këpucëve të njeriut, ajo është prishës i kënaqësive njerëzore, ndarës i bashkësive. Këtë e kanë shijuar njerëzit të cilët kanë qenë shumë më të mirë se ne, të cilët madje gjithë jetën ia kushtuan botës tjetër-ahiretit me punën dhe veprën e tyre, për këtë arsye duhet ta përkujtojmë vdekjen dhe njëkohsisht të punojmë për atë e cila na pret pas saj, pra jeta e përhershme.

Shkaqet të cilat çojnë deri tek ngurtësimi i zemrave

Të dashurit e mi dijeni se ngurtësimi i zemrës është sëmundja e rrezikshme me të cilën jemi sprovuar në këtë kohë, e ndëgjojmë Kur'anin Famëlartë përsëri zemrat tona nuk ndikohen, prezantojmë në varimin e vëllëzërve tonë mësim nuk marim, dëgjojmë këshilla të ndryshme rëndë përkujtohem, e gjitha kjo sepse zemrat tona janë forcuar dhe ngurtësuar. Por një gjë e dim, se çdo sëmundje që egziston veçse Allahu për të ka zbritur ilaçin e saj, e pa dyshim se ilaçi më i mirë i zemrës së sëmurë është leximi i ajeteve të Kur'anit, duke i kuptuar ato dhe duke medituar mbi to, pasi që ky libër nëse do të shpallej apo të zbriste mbi një kodër do ta shihje kodrën të struktur e të çarë prej frikës nga pronari i këtij libri, Allahut Fuqplotë, thotë Allahu në Kur'an:” **Libër të cilën ta zbritëm ty** (o Muhamed), **i begatshëm që ti studiojnë argumentet e Tij.**”(Sad:29)

Sa e sa këshilla dhe mësim ka në ajetet e suret e këtij libri, mirëpo siç ka thënë vet Allahu:” **Edhe pas** (fakteve të qarta) **zemrat tuaja u bënë të forta si guri apo edhe më të forta se guri.**” (Bekare:74)

I Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshra e Allahut qofshin mbi të) na ka këshilluar me një këshillë prekësë, e shkurtër por me kuptim të madh, madje për këtë janë të pajtimit të gjithë dijetarët se kjo këshillë është një prej këshillave më të mira të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshra e Allahut qofshin mbi të), e kjo pa dyshim nuk është për tu habitur sepse të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshra e Allahut qofshin mbi të) i janë dhënë “Xhevamiul kelam” – fjalë të pakta por me kuptim të lartë, e kjo këshillë është:” *Përmendeni sa më shumë prishësin* (shkatëruetin) *e kënaqësive.*”, pra vdekjen.

Po vëlla i dashur prej atë ditë të cilën e kemi haruar vdekjen dhe agoninë e saj, varrin dhe erësirën e tij, llogarinë dhe qortimin gjatë jetës në të, urën e siratit dhe hollësinë e saj, kur i haruam gjitha këto na u ngurtësuan zemrat tona, e na janë bërë sikur gurëzit, madje edhe më të ngurta. Pra për këtë arsye i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshra e Allahut qofshin mbi të) ka thënë:” *Përmendeni sa më shpesh prishësin e kënaqësive.*”

Nuk i përmendet vdekja një të forti vetëm se e dobëson atë, nuk i përmendet atij i cili mburet apo krenohet vetëm se e nënçmon atë, nuk përkujtohen shumica me të vetëm se i pakëson ato, sepse VDEKJA...është VDEKJE.

Nuk mund të ikësh prej saj, e as të fshehesh dikund

Ku të zbret e bën varr atë vend

Këtë e shohim me sytë tanë, e kjo është realitet

Mirëpo edhe pse e dimë së është realitet duam ta përgënjeshtrojmë

Tek Allahu ankohe mi për ngurtësinë e zemrave tona

Sikur këshilluesi vdekja çdo ditë mban zi e qanë

Shpresojmë me shpresë të gjatë dhe e presim prodhimin e saj

E ndoshta vdekja është më afër se shpresat tona

Vdekja është siç kanë thënë dijetarët: Ndarja e shpirtit nga trupi apo pauzë në mes këtyre të dyjave, kalim prej një gjendje në një tjetër, kalim prej një vendi në një tjetër, madje Allahu për këtë arsye dhe e ka quajtur fatkeqsi, ka thënë:” **Nëse jeni në udhëtim dhe ju gjen fatkeqësia (telashja) e vdekjes.**” (Maide:106) Mirëpo fatkeqësia më e madhe, Allahu na ruajtë është gafleti-shkujdesja ndaj vdekjes, mos përkujtimi i saj dhe mos përgatitja për të, e kjo pa dyshim se është edhe më e madhe se vet vdekja.

Nuk është e rastësishme se si komentatorët e Kur’anit ajetin:” **Ai është i Cili krijoi vdekjen dhe jetën për t’ju provuar se cili prej jush është më vepër mirë.**” (Mulk:2) e kanë komentuar duke thënë se e ka kuptimin: Ai i cili më shumë e përmend dhe e përkujton vdekjen ai përgatitet më shumë për të. Ebu Alij Ed-dekik (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: Kush e përmend shpesh vdekjen fiton tre gjëra:

E para: pendohet shpejt, e dyta: është aktiv i disponuar në adhurime, dhe e treta: është i lumtur shpirtërisht. Kurse ai i cili e ka haruar vdekjen humbë apo dënohet në tre gjëra:

E para: vonohet në të penduarit e tij tek Allahu, e dyta: ndejn vështirësi në adhurim dhe e treta: nuk është i rehatshëm shpirtërisht.

Pra ajo e cila ndikon në zemër është të përkujtuarit e vdekjes, në gjendjen e saj, agoninë e saj, varin dhe erësirën e tij, prandaj dhe i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë:” Me të vërtetë në fillim ua kisha ndaluar ti vizitoni varrezat, e tani ju urdhëroj ti vizitoni sepse ata ua përkujtojnë vdekjen.”

E prej asaj dite kur njerëzit e haruan vdekjen dhe jetën e amshueshme, e lanë namazin, u zhytën në detin e mëkateve dhe haremeve të ndryshme e u larguan njerëzit nga urdhërat e Allahut...

O ti i pakujdesshëm i cili nuk vepron
E të ka mashtruar shpresa e gjatë
Vdekja të vjen papritmas
Kurse varri është sandëku i veprës

A ke menduar ndonjëherë kur ke dalur nga shtëpia yte herët në mëngjes se vallë a kthehesh për së dyti në shtëpinë tënde? A ke menduar vallë se kjo mund të jetë dita e fundit e jetës tënde? E në qoftë se tani në këtë moment të vjen meleku i vdekjes të ta mer shpirtin, vallë a je i kënaqur me veprat që i ke bërë? Mos u habit Allahu të ruajtë por jepi përgjigje vetvetes, sepse kjo nuk është aspak ekagjërim në pyetje, a je apo jo i përgatitur për ta takuar Allahun tënd?

Një njeri të cilin e njoh u paraqit tek familja nga ora një e drekës dhe u tha: Sot kma marë leje për të dalë nga puna para kohe më tregoni çfarë duhet t’ju sjell në shtëpi? I thanë: Duhet kjo dhe kjo. Tha: ora një jam aty inshAllah. Kaloi një orë, dy, tre mirëpo nuk erdhi fare. Kur para namazit të akshamit u paraqit në numrin e kësaj shtëpie dikush dhe u tha: Allahu ju lashtë shëndoshë juve sepse familjari juaj sa doli nga puna bëri ndeshje me një makinë dhe ndërroi jetë.

Më trego për Allahun: Vallë a ka menduar ky njeri kur është nisur për në shtëpinë e tij se nuk do të mund të mbrinë në të, apo a u ka shkuar ndërmend familjarëve të tij se ai i cili i bartë nevojat e tyre shtëpiake nuk do të mund të vijë tek ata këtë ditë?

Një njeri nga njerëzit e devotshëm i cili banonte në pjesën më të lartë të fshatit të tij ngritej në pjesën e fundit të natës, diltë në kopshtin e tij dhe thëriste me tërë fuqinë e zërit të tij duke thënë: Përgatituni për vdekjen, përgatituni për vdekjen, përgatituni për vdekjen. I përsëriste

këto fjalë vazhdimisht dhe i dinin njerëzit se kush e bën këtë pothuajse çdo natë, mirëpo erdhi një kohë kur ky mungoi për një kohë të gjatë, pra nuk ndëgjohej ai zë në fundit e natës. Si pasojë prijësi i atij fshati pyeti se ku është filani, i thanë se ka vdekur. Tha: çdoherë i përkujtonte njerëzit për vdekjen derisa vdiq edhe vetë. Po ai vdiq por si vdiq? çdoherë duke i këshilluar të tjerët për vdekjen derisa e kaploi ajo për të cilën këshillonte edhe vet atë, porse ajo kur i erdhi e gjeti të përgatitur për të, të kujdesur duke mos u mashtruar me shpresat e gjatë të kësaj jete.

Ka qenë Sufjan eth-Theuri (Allahu e mëshiroftë) të cilin njëherë i kanë thënë: Nëse do të thonin se shpejt do të vdesish çfarë lloj veprash do të bëjë për në fund të jetës tënde? U përgjigj duke thënë: Nuk do të shtoja as një vepër më shumë edhe sikur ta dija kur do të vdisja. Pra ky njeri e ka adhuruar Allahun çdo herë sikurse me qenë dita e tij e fundit, duke mos lënë vepër të mirë pas dore gjatë tërë kohës, prandaj edhe sikurse ta dinte se kur do vdiste nuk do të mund të shtonte asnjë vepër më shumë.

Një njeri njëherë i ka thënë shokut të tij i cili ishte larg rrugës udhëzimit:

- O ti fulan, në qoftë se vdes në këtë hall a do të jesh i kënaqur? – i tha:

- Jo vallahi! Atëherë i tha:

- Po a kë bërë nijet ta ndërosh hallin në të cilin je në një gjendje në të cilën do të jesh i kënaqur me veprat e tua madje edhe në qoftë se vdes në atë gjendje? – i tha:

- Nuk më ka shkuar ndërmend për këtë asnjëherë! Ia ktheu pyetësi

- Po pas kësaj bote a ka botë me shpresa?! – iu përgjigj mëkatari duke thënë:

- Jo vallahi! – atëherë i tha:

- Vallë çfarë mëndon në qoftë se të vjen meleku i vdekjes e ti je në këtë gjendje që je?!

Do të shpërngul ty vdekja nga shtëpia yte

Do ta zavendësoj ty vdekja shtëpinë me një shtëpi tjetër

Po të lësh çdo gjë për të cilën je munduar një kohë të gjatë

Prej pasurisë tënde do të biesh në varfëri

Në sytë e tu krimbat e varrit do të shoqërojnë

Ndërsa shtëpinë tënde do ta gëzojnë të tjerë në vendin tënd...

Po vëllau im shumë i dashur: Mos e haro vdekjen, sepse janë të pajtimit gjithë dijetarët se vdekja nuk ka vend të caktuar, e as kohë të caktuar e as arsye të caktuar kur vjen, e as jeta është e caktuar që ta dish se kur ajo do të viziton, por vin krejt papritmas pa e shijuar, thotë Allahu në Kur'an:” **Thuaj: Ska dyshim se vdekja prej së cilës po ikni ka për t’ju zënë, e pastaj do të ktheheni tek Ai, që e di të padukshmen dhe të dukshmen, e atëherë Ai do t’ju njoftoj për atë çfarë keni punuar.**”(Xhuma:8)

“ **Agonia e vdekjes është e vërtetë që do tu vjen, kjo është ajo prej të cilës ti po ikje.**”

(Kaf:19) Që do të thotë kur ti vjen vdekja dikujt i thuhet: Kjo është ajo prej së cilës ti mundoheshe të ikësh. Prandaj gjatë ose shkurt një ditë do të vjen vdekja patjetër.

Njerëzit në prag të vdekjes ndahen në dy kategori:

E para: e cila e dëshiron takimin me Allahun dhe Allahu e dëshiron takimin me to.\

E dyta: e cila e uren takimin me Allahun dhe Allahu e uren takimin me to.

Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) ka thënë: O i Dërguari i Allahut çdo kush prej nesh e uren vdekjen? – i tha i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të):” Nuk është ajo qëllimi o Aishe, robit të devotshëm kur i vjen vdekja, melekët e përgëzojnë atë me xhenet, se Allahu është i kënaqur prej tij, e jo i hidhëruar, atherë ky rob e dëshiron takimin me Allahun dhe Allahu e dëshiron takimin me të. Ndërsa robi mëkatari i cili ka qenë

i shkujdesur nga vdekja dhe nuk ka punuar për këtë ditë i vinë melekët në prag të vdekjes dhe e përgëojnë me hidhërim dhe dënim nga ana e Allahut, atëherë ky e uren takimin me Allahun dhe Allahu e uren takimin me të.

Omer ibn Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë) u ka thënë bashkëbiseduesve të tij: Kur të uleni me mua ju kushtëzohet me tri gjëra në qoftë se doni që të rini me mua në një mexhlis: E para: Mos flitni për dynjanë, e dyta: mos merni nëpër gojë dikënd, dhe e treta: mos talleni e të bëni shaka asnjëherë. Kështu që e përkujtonin vdekjen, agoninë e saj, varrin, erësirën e tij, e kur ngriteshin nga mexhliset me Omer ibn Abdulazizin ngriteshin sikurse nga ndonjë xhenaze, çfarë këshillat të dobishme nëse do ti kishin praktikuar edhe neve sot... Prandaj nuk është për tu habitur për këtë burrë kur në fund të jetës së tij kanë treguar se ai e ka lexuar ajetin e Kur'anit në të cilin Allahu thotë:” **Ky është xheneti të cilin e kemi përgatitur për ata të cilët nuk e duan mendjemadhësinë në tokë e as çrregullimin, e përfundimi i mirë u takon të devotshmive.**” (Kasas:83)

Dynjaja sa e sa të të zgjatet ajo është e shkurtër, sa më shumë që të të duket e madhe ajo është e pavlerë, do të vijë një ditë kur do të palosesh në shtrat, do të dëshirosh ta përqafosh të voglin tënd mirëpo nuk do të mundesh, të mëdhejtë e tu por nuk do të mundesh sepse Ajo do të ndan për një çast nga çdo gjë e dashur për ty në këtë botë dhe atë pa të pyetur aspak.

Mjer për ty si do të jetë gjendja yte në ao momente, atë ditë kur syte e tu fryhen, ftohen gjymtyrët e tua , ndahen kërcit e këmbës, dëshiron të flasësh mirëpo nuk mundesh , dëshiron të thuash diçka mirëpo nuk mundesh:” **Dhe kur të vjen agonia e vdekjes hak** (e vërtetë) **kjo është ajo prej së cilës ti po ikje, e kur ti fryhen surit, kjo është dita e premtuar, e atë ditë çdo njeri do të vijë bashkë me dëshmiarin dhe grahësin.**” (Kaf:19-21)

Llogariteni veten para se të llogariteni

Keni frikë Allahun qani për veten tuaj para se të qajnë për ju, llogaritni veten tuaj para se të llogariteni, bindjuni Allahut para se t’ju mbajnë mbi supe, përgatituni për vdekjen para se të thoni : O Allah o Zoti im më kthe në dynja të bëj vepra të mira! E ti mos ju dëgjon kush. Një orë të ulësh dhe llogaritësh veten tënde është shumë mirë se ditë dhe orë të cilat ta humbin kohën kot.

Ditët po kalojnë e ku është përgatitja për vdekjen
Ku është mendjemadhësia në shtëpinë e të këqijave
Ku mbet vendosmëria yte, a u kënaqë me pak
Sepse belaja e epshit nuk i ngjan ndonjë belaje tjetër
Si dhe çështja ekohës nuk është diçka e pavlerë
O ju të cilët nuk po shihni do të zbulohen për ju të fshehurat
Meleku i vdekjes nuk pranon njohftësi e as ndërmjetësim
E as që pranin dhurata
O ti i ri do të pyetesh për rinine tënde
O ti plak do të përgjigjesh për jetën tënde
O ti i cili ke mbri të tridhjetat mendo para se të të mbyllet dera
O ti i sëmurë në zemër qëndro para mjekut
O ti i pafat qaj për humbjen e të atit tënd
Për zotrillëkun tënd ri para derës dhe mendo gjatë
Shfrytëzo jetën para vdekjes ndërsa ti je nëglizhent ndaj saj
O ti të cilit vdekja përpara te rrotullohet

O ti i cili rinë qetë në shtëpi e në pallate
 Sikur ta mendosh veten tënde të varosur dhe të meditosh se çfarë ka në të
 Atherë syri yt tek ti po lëviz
 O ti i cili e ke zemrën në erësirë e jo në dritë
 Mbrenda je i prishur e jashtë i ndërtuar
 Mirëpo shikohet në brendësi e jo në formalitet
 O ti i cili sa më shumë që jeton i shton mëkatet e tua
 O ti i cili lundron me mendjen tënde në mëkate
 O ti i cili ke mendon shkurtë kurse të është krusur trupi
 O ti i cili pak mer mësim ndërsa e din se vari fortë shtrëngon
 Si ta këshilloj atë të cilin i ka vdekur zemra e jo truri dhe trupi i tij...

Po vëlla i dashur patjetër për udhëtimin për në botën tjetër jetove gjatë apo shkurtë, do të vijë ajo ditë kur do të ndahesh nga kjo jetë, mirëpo si do të jetë gjendja yte në ato momente, para këtij udhëtimi?!...

Vdekja e të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)
“Ti do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.”

Ajo e cila i vonon njerëzit nga pendimi tek Allahu dhe përgatitja për ahiet është shpresa e gjatë, për këtë Allahu thotë në Kur'an:” **Leri ti ata të hanë e të pinë e ti mashtrojnë ata shpresat e gjata e pastaj do ta kuptojnë ata.**” (hixhr:3) Çdo kush do ta shijojë vdekjen përveç Atij të cilit i takon krenaria dhe i Cili është i Gjithëfuqishëm. “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Çdo kush do të vdes sepse Allahu ka thënë:” **Ti do të jesh i vdekur (o Muhamed) dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) gjithashtu ka thënë:” **Asnjë njeriut nuk ia kemi mundësuar të jetë i përjetshëm, edhe në qoftë se ti vdes ata (mushkrikët) nuk do të jetojnë përgjithmonë.**”(Enbija-34) “**Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen.**” (Ali Imran:185)

Vdiq edhe i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i cili pak para vdekjes tha:” *Mallkimi i Allahut qoftë mbi jehudët dhe krishterët të cilët i shëndruan varezat e profetëve të tyre në faltore.*” Po ashtu një nga porositë e tij para vdekjes ishte:” *Namazin, namazin dhe ata të cilët i keni nën pronësinë tuaj.*” Që do të thotë se keni kujdes të veçantë ndaj këtyre dy gjërave , namazin mos e humbni në asnjë mënyrë dhe të silleni drejt ndaj atyre që i keni nën kujdesin dhe pronën tuaj.

Kur u ngjit për herë të fundit i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në minber i tha sahabëe të tij:” *Kujt ia kam marë diçka ja ku e keni mallin tim mereni, kujt ia kam cenuar nderin, ja ku e keni nderim tim hakmeruni, kujt i kam rënë, goditur le të ma kthen, disa nga robërit e Allahut Ai ua bëri që të zgjedhin në mes shpërnguljes tek Ai dhe bukurivë të kësaj bote e robi i Tij zgjodhi atë çfarë është tek Allahu.*” Atëherë Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) filloi të qaj kurse sahabët u habitën më të se pse qantë, e ai qante sepse e kuptoi shpejt se këto janë ditët e fundit të Muhamedit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në këtë jetë.

Në çastët e fundit të jetës së tij i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e lagte dorën e tij me ujë dhe e fërkonte me dorë fytyrën e tij dhe thoshte:” La ilahe il-Allah, vdekja paska agoninë e saj, o Allah ma lehtëso mua vdekjen dhe agoninë e saj.” Kur

e pa Fatimeja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) pra vajza e të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në këtë gjendje babain e saj se në çfarë vështirësish po kalonte ai i tha: O dhimbja e babait tim! Atherë i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tha:” *Oj Fatime babai yt nuk do të ketë dhimbje pas sodit.*” Pastaj e ngriti shikimin drejt qiellit dhe bënte shenjë me gishtin tregues të tij dhe thoshte:” *O Allah më fal mua, më mëshiro , ma prano pendimin, tek shoku im i Cili është më i Larti.*” Pas kësaj u ndal frymëmarja më fisnike, u ndal se punuari zemra më mire e njerëzimit, u shkëput përgjithmonë lidhja e qiellit me tokën-shpallja deri në kijamet, ndërroj jetë njeriu me moralin më të lartë, vdiq njeriu që është dashur më së shumti në sipërfaqen e tokës nga shokët e tij dhe nga pasusit e tij..., e pa dyshim se kjo do të ndodhte pasi që Allahu ka thënë:” **Ti do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe “ **Çdo shpirt do ta shijoj vdekjen.**” (Ali Imran:185) Pasi doli shpirti nga trupi më i bekuar që ka parë historia e njëërëzimit nga trupi i të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), vajza e tij Fatimeja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) tha: O babau im, iu përgjigje ftesës së Zotit tënd, Firdeusi është vendi yt, o babau im Xhibrili më nuk vjen pas vdekjes tënde. Pa dyshim fjalë rënqethëse...e si mos të jenë kur bëhej fjalë për profetin më të dashur të Allahut Fuqiplotë.

Pasi që e varosën sahabët të Dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), Fatimeja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) i tha Enesit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) : O Enes si e morët guximin ti hedhni dhe trupit të Dërguarit të Allahut?! Enesi ia ktheu: Të betohem në Allahun se nuk kishim guxim, mirëpo e detyruam veten pa dëshirë për një gjë të tillë. Vdiq i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) edhe pse këtë se besonte dot fillimisht Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) porse e qetësoi me disa fjalë Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) duke thënë se : Ta dinë ata të cilët e kanë adhuruar të Dërguarin e Allahut, ai vdiq, kurse kush e ka adhuron Allahun le ta dijë se Ai nuk vdes. Muhamedi i biri i Abdullahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) sepse Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Më pas, pas dy vitesh vdiq edhe Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), halifja e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) të cilin e vendosi tu prijë sahabëve në namaz kur ishte i sëmure vet me gojën e tij të ëmbël, i cili e udhëhoqi umetin më shumë përgjegjësi pas vdekjes së Pejgamberit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Ndëroj jetë ky halif i parë i muslimanëve gjatë natës, kur ishte në çastet e fundit të jetës së tij e pyeti vajzën e tij Aishen (Allahu qoftë i kënaqur prej saj):

- Çfarë dite jemi sot? – i tha vajza e tij:
- E hënë? – e pyeti përsëri:
- Çfarë dite ka vdekur i Dërguari i Allahut? – i tha Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj):
- Ditën e hënë.

E kishte parë të Dërguarin e Allahut në ëndër shumë herë, kurse kur e pyetën në ato çaste se të ka vizituar ndonjë mjek për gjendjen tënde, ua ktheu duke u thënë:

- Po më ka vizituar. – e pyetën:

- Çfarë të tha? – ua ktheu Ebu Bekri (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të):
- Unë do të bëj çfarë të dua!

Kur vërejti Aisheja (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) se babai i saj po kalon çastet e fundit të jetës së tij, për t'ja qetësuar gjendjen filloi ti këndoj disa vargje të një poezi ku thuhet:

Çfarë është ky gjykim dhe kujdesje prej XXXXXXXXXXXXX
Në qoftë se sot derxhet prej vdekjes e i ngushtohet gjoksi...

- Ia ndërpreu babai i vet fjalët duke i thënë:
- Mos thuaj ashtu oj Aishe, oj bija ime, po thuaj:
- “**Dhe të ka ardhur vdekja e cila është hak - e vërtetë, e kjo është ajo rrej së cilës ti ikje.**” (Kaf:19)

Po vëllau im i shtrejtë:ashtu është sepse ka thënë Allahu në Kur'an:" Thuaj: Vdekja prej së cilës ju mundoheni të ikni do t'ju kaplon, pastaj do të ktheheni tek Ai i Cili e dinte të dukshmen dhe të padukshmen dhe do t'ju njohtoj për atë që keni vepruar." (Xhumua:8)

Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) e këshilloi Omer ibn Hatabin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) pak para vdekjes, me një këshillë sikur ta kuponim këtë këshillë sa mirë do të ishte, i tha : O Omer Allahu ka një hak gjatë natës të cilën nuk e pranon gjatë ditës dhe ka një hak gjatë ditës që nuk e pranon gjatë natës. Vdiq njeriu më i dashur tek zemra e të Dërguarit të Allahut, i sinqerti , sidiku , shoku më i ngusht i shokut të Allahut, këtë siç e ka thënë vet i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në një hadith të tij, ai i cili peshonte më shumë se gjithë umeti në peshoren e të Dërguarit te Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Vdiq Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) sepse Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e Omer ibn Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Pas njëmbëdhjetë vitesh si halife vdiq edhe Faruku - Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) edhe atë siç dihet më 23 Dhul-hixhe të vitit 23 hixhri duke falur namazin e sabahut si imam, theret me thikë nga Ebu Lu'lu el-Mexhusi. Ditën kur nuk u plotësua namazi i sabahut, e ai nuk u plotësua për shkak të ndonjë moskuptimin të çështjet e shariatit, e as për shkak të ndejes para televizorit tërë natën, por për shkak se u plagos halifi i muslimanëve, e u vranë dhe u plagosën disa besimtarë të tjerë po nga ky person duke ikur përmes rrjeshtave të xhematit në atë namaz të sabahut, e kur u godit me thikë ai ishte duke lexuar fjalën e Allahut:” **Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut.**” (Jusuf:56) Ra i alivanosur halifja i muslimanëve, shpata e Allahut, shehidi i minberit. E kur erdhi në vetëdije fjalën e parë që ua tha shokëve të tij ishte:

- A u fal namazi, a u falën njerëzit!?

Medito vëlla mbi këto fjalë, ndëgjoje cila ka qenë fjala e parë pasi që është therur Omer ibn Hatabi me thikë. Po neve duke mos na mungua asgjë nga pasuria dhe shëndeti sa kujdesemi për namazin tonë!?

Pasi që e kuptoj Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se ka gjakderdhje të madhe nga plaga e kuptoj se ishte në çastet e fundit të jetës së tij, por edhe në këtë gjendje atë përsëri diçka e preokuponte dhe e mundonte. E thiri të birin e vet Abdullah ibn Omerin (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) dhe i tha:

- Shko te Aisheja, nëna e besimtarëve dhe thuaj se të bën selam Omeri, dhe mos i thuaj prijësi i besimtarëve sepse prej sot unë nuk jam prijësi i besimtarëve. Dhe thuaj se Omeri kërkon prej teje leje që ta lejosh të varoset bshkë me dy shokët e tij (të Dërguarin e Allahut dhe Ebu Bekrin).

Kjo të bën te mendosh se me kë ka qenë i lidhur Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) edhe në këtë gjendje të rëndë, e pa dyshim se këto fjalë dhe këto dëshira në këto çaste dalin vetëm se nga njerëz të mëdhej të umetit sikurse ishte Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij).

Shkoi Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tek Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) dhe ia tregoj dëshirën e babës së vet. Iu drejtua nëna e besimtarëve Aisheja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) të birin të Omerit dhe i tha:

- Betohen në Allahun se atë vend e kisha ruajtur për vëtë, mirëpo nëse ajo është dëshira e fundit e Omerit do ti jap përparësi.

U kthye Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tek babai i tij, kur e pa babai i vet tha:

- Me ulni – pasi ishte shtrirë – pastaj e pyeti djalin e vet:

- Çfarë të tha o biri im Aisheja? – i tha djali i vet:

- Të përgëzoj o babau im se ajo u pajtua me mendimin tënd!

Në këto çaste shëndriti fytyra e Omer ibn Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) nga gëzimi sepse iu realizua dëshira e tij e cila e brengoste në ato çaste, brenga e cila për të ishte pa dyshim e madhe, e nuk ishte si e brengat tona siç janë në ato çaste për mallin e tij, për hallallëkun e tij, për familjen e tij, për pronat e tij etj, porse ishte që të varoset afër të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) që të jetë me të shokë në këtë botë dhe në boën tjetër. Pas kësaj Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tha:

- Në qoftë se vdes ma lani xhenazen, pastaj ma qefinosni, pastaj trokitni tek dera e Aishes dhe thuani se Omeri po kërkon leje përsëri për së dyti të varoset afër të Dërguarit të Allahut dhe Ebu Bekrit, e në qoftë se u lejon atëherë më varosni, e nëse nuk ju lejon atëherë më varosni tek vareza e muslimanëve. Pak para me se ndërë jetë na çastet e fundit të jetës së tij, djali i tij Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) e vendosi kokën e tij tek kofsha e tij (sepse Omeri e kishte kokën në tokë) kur e pa këtë veprim Omeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i tha:

- Lere kokën time në tokëse ndoshta Allahu do ta mëshiron Omerin, ah i mjeri unësikur të dilja nga kjo botë duarthatë pa asnjë post, as për ju e as mbi ju (d.m.th. pa këtë përgjegjësi të madhe si halif i gjithë besimtarëve në atë kohë), do të kisha dëshiruar që të mos më kishte lindur nëna, e sikur të kisha qenë një gjeth i cili në vjeshtë vyshket dhe kur bie në tokë bëhet copë copë, grimcohet.

Kush ishte ky burrë me emrin Omer ibn Hatabi? Ky ishte ai i cili falej tërë natës, agjëronte shumë, të cilin nga të qarat e shumta ishin bërë dy viza në faqet e tij nga lotët si pellgu i lumit, i cili mori pjesë në gjithë betejat me të Dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), frigëj vazhdimisht se mos jetë nga munafikët prej të cilëve kishte paralajmëruar i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) edhe pse ishte i përgëzuar me xhenet qysh në këtë jetë...dhe përsëri i thoshte këto fjalë "Sikur të isha një

gjethë i cili vyshket në vjeshtë...” që të mos meret në llogari ditën e gjykimit nga Allahu i madhëruar. Vdiq Omer ibn Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) sepse Allahu ka thënë:” **Ti** (o Muhamed) **do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “**Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e Othman ibn Afanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Pastaj prijës i besimtarëve u bë Othman ibn Afani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i cili i duhëhoqi muslimanët për njëmbëdhjetë vjet. Por pas lindjes së trazirave të shumta në umet nga fraksione të ndryshme dashakeqe erdhi edhe deri tek vrasja e Othman ibn Afanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij). Atë ditë që vdiq ky sahabi u urtë, dhëndri i të Dërgautri të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e pa në ëndër të Dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i cili i tha: Sonde do ta hash iftarin me neve. (d.m.th. me mua, Ebu Bekrin dhe Omerin) E pas kësaj ëndre atë ditë ia rethuan shtëpinë halifit të muslimanëve i cili i refuzoj që ta ruajnë atë natë djemtë e Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) Husejni dhe Haseni (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre). Pasi që sahabë e kishin kuptuar se në ato kohra trazirash mund ta vrasin edhe halifen e muslimanëve dhe shumica e sahabëve nuk ishin në Medine por kishit shkuar në Meke në haxh. Kur hyn atentorët në shtëpinë e Othman in Afanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) fillimisht ia lënduan bashkshorten e më pas e vranë dhe halifen duke lexuar Kur’an. Shpërtheu gjaku i halifes e cila ia kaploi mjekren e tij të çastër, ishte i agjërueshëm dhe ndëroj jetë duke e bërë lutjen e tij të fundit: La ilahe il-la ent, Subhanek, in-ni kuntu minedhalimin – Nuk ka të adhuroar përveç Allahut, i lartësuar është Allahu, e unë jam nga keqbërësit. Ra i vdekur ky burrë i urtë, duke e mbaruar jetën e tij me lutjen e Junusit (paqa e Allahut qoftë mbi të), ndëroj jetë njeriu nga i cili kishin turpë edhe melaiket, e kjo sipas një thënie të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

E kush ishte Othmani r.a.? Ai ishte sahabiu i cili qante shumë nga frika e Allahut, kur i përmendje varri dhe jeta në të, ai qante pa masë sa që ia zbutnin mjekrën lotët e tij nga të qarit e tepërt. E kur e pyetën se pse qante më shumë kur përmendej varri se sa xheneti dhe xhehenemi, u thoshte:

- E kam dëgjar të Dërguarin e Allahut duke thënë:” *Varri është shtëpia e parë në ahiret, në qoftë se në var gjatë llogarisë i ecin mirë punët robit atëherë çdo gjë pas saj do të jetë mirë për të, e nëse gjatë llogarisë në var nuk i ecin punët mirë robit atëherë çdo gjë pas saj nuk do të jetë mirë për të.*”

Vdiq Othmani, sahabiu i cili në një luftë e ndihmoi ushtrinë muslimane me gjithë pasurinë e tij duke i dhuruar asaj për afërsisht 900 kuaj dhe 90 deve, e si pasojë e kësaj tha i Dërguari i Allahut (paqa e Allahut qoftë mbi të):” *Nuk i bën dëm Othmanit pas kësaj dotë asgjë.*” Ishte lexues i madh i Kur’anit të lartë, baba i jetimëve, i vejushave, i të vobektëve. Vdiq Othmani (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) sepse Allahu ka thënë:” **Ti** (o Muhamed) **do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “**Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e Ali ibnu Ebu Talibit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Pas Othmanit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) siç e dim u bë halife Ali ibnu Ebu Talib (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), në kohën e tij ndodhën shumë trazira të brendshme të cilat Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i përballoi të gjitha me sukses. Por në një mëngjes pak kohë para namazit të sabahut në kohën e istigfarit, pasi që Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) e kishte falur namazin e natës doli për në xhami. E sulmuan rrugës për në xhami dhe e vranë nipin e të Dërguarit të Allahut (paqa e Allahut qoftë mbi të). Vdekja e tij është shumë larg disa vdekjeve të tjera në këtë kohë, ku njerëzit sot në këtë kohë vdesin pasi që kanë bërë shumë mëkatë gjatë natës e në mëngjes në gjendje të ndryshme i gjën vdekja, kurse të parëve tanë të mirë, vdekja u ka ardhur duke shkuar në xhami, duke luftuar në rrugën e Allahut, duke dhënë këshilla e kështu me radhë.

Kur i erdhën çastet e fundit të jetës Aliut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tha: Nëse unë mbetem gjallë ma leni mua në dorë personin që më lëndoi, e unë do vendos nëse do ta vras ose do ta lëshoi të lirë, por nëse unë vdes atëherë ju vriteni atë, sepse unë do ti hakmerem atij në ditën e gjykimit përpara Allahut Fuqiptotë. Nuk shkoj shumë kohë pasi tha këto fjalë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) vazhdoi ta përsëris shehadetin vazhdimisht derisa ndërroj jetë. Vdiq “luani i Allahut”, muxhahidi i muslimanëve, prijësi i tyre, nipi i të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Vdiq Aliu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) pasi që Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Ebu Hurejra, transmetuesi më i madh i haditheve, shoqëruesi më i mirë i të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ai i cili, pasi që e pranoi islamit nuk u nda nga i dashuri i tij Muhamedi (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ai prej të cilit na transmetohet një pjesë e madhe e sunetit të të Dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kur i erdhën çastet e fundit të jetës tha:

- Ah sa pak jam përgatitur për këtë ditë, rruga është tepër e gjatë kurse unë kurse furnizimi i im për këtë rrugë është shumë i pakët.

Këto fjalë dolën nga goja e atij i cili nuk u nda nga i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) derisa i Dërguari ynë nuk ndërroj jetë, transmetuesi i madh i dijes, ai i cili e mësoi drejt për drejt islamit në çdo aspekt të tij nga ai mbi të cilin u zbrit kjo fe, e çfarë na mbetet neve të themi për vdekjen, kur e dim se sa neglizhent dhe të shkujdesur jemi? Çfarë do themi ne që na kanë mbuluar mëkatet që nuk mërzhitemi për kohën që na kalon kot, duke mos përfituar nga ajo?

Vdiq ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) sepe Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Vdekja e Muadh ibn Xhebelit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij)

Në historinë e sahabëve nuk mundemi pa e përmendur edhe këtë sahabi të madh, këtë person për të cilin vet i Dërguari i Allahut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tha me gojën e tij se është më i dituri mbi hallallin dhe haramin, ambasadori i të Dërguarit të Allahut (paqa dhe

mëshira e Allahut qofshin mbi të) që u dërgua nga vetë ai në Jemen për ta përhapur fjalën e Allahut. Çastet e fundit të jetës ky sahabi i bëri para sabahut, kur ishte në prag të vdekjes e pyeti djalin e tij:

- A erdhi koha e sabahut? – i tha djali i vet:

- Jo akoma. – E pyeti përsëri pas pak kohësh”

- A erdhi koha e sabahut? – i tha djali i tij:

- Jo akoma. – e pyeti për së treti:

- A erdhi koha e sabahut? – ia kthue përsëri djali i tij:

- Jo akoma. – atëherë tha:

- Kërkoj mbrojtje nga ajo natë pas të cilës sabahu i saj të çon në zjarrë. – pastaj u dejtua me lutje dhe tha:

- O Allah vetëm ti e din se unë me të vërtetë të kam patur frikë Ty, ndërsa tash shpresoj vetëm prej Teje. Ti e din se unë nuk e kam dashur dunjanë për të ndejt gjatë në të, e as për rrjedhjen e lumejve të saj, e as për pemët e saj. Por e kam dashur për të agjëruar në ditët e nxehta të saj, për namazin e natës dhe për ndejat me të diturit nga shokët e te Dërguarit të Allahut.

Medito vëlla i nderuar rreth fjalëve të këtij sahabiu dhe të tjerëve nga ata, se pse kanë qajtur dhe për çfarë janë mërzitur?!

Ndërsa ne”

Epsi qanë për dunjanë edhe pse e din se shpëtimi është ta divorcon atë

Njeriu pasi të vdes nuk ka shtëpi ku të banoj

Pos asaj shtëpie të cilën e ka ndërtuar

Ne qoftë se e ka ndërtuar më të mira lum për banimin në të

Ne qoftë se e ka ndërtuar me të këqija mjr për banimin në të

Vdiq Muadh ibn Xhebeli sepse Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Po ashtu transmetohet se një grua e devotshme e cila në vete e ndjejt se i është afruar vdekja, iu drejtua burrit të saj dhe i tha:

- Dua të shkoj në Mekke, dua ta shoh shtëpinë e Allahut-Qaben. – Para se të niset i përshëndeti të gjithë fëmijët e saj, sikurse më nuk do të ketë mundësi ti takon përsëri.

E bëri tauafin dhe sajën, e kreu umren, iu drejtua Allahut dhe ju lut sinqerisht. Kur morën rrugën për tu kthyer pësuan të dytë një aksident dhe dhe gruaja u lëndua rëndë në kokë. Menjëherë pas aksidentit burri i saj e nxori nga vetura e aksidentuar në një anë të rrugës që ta qetësoj, porse gruaja ishte në çastet e fundit të jetës së saj, e ngriti gishtin tregues në qiell dhe tha:

- La ilahe il-Allah - pastaj iu drejtua burrit të saj dhe i tha:

- Bënu selam familjes time dhe thuaju se takimi ynë i ardhshëm do të jetë në xhenet.

Vdiq kjo grua e devotshme pas umres , me këto fjalë bindesë pasi që Allahu ka thënë:” **Ti (o Muhamed) do të jesh i vdekur dhe ata do të jenë të vdekur.**”(Zumer:30) dhe ka thënë: “ **Çdo gjë do të zhduket përveç fytyrës së Zotit tënd që është i madhëruar dhe i nderuar.**”(Rahman:26-27)

Përfundimi i keq

Dallimi mes të devotshëve dhe mëkatarëve dallon shpesh edhe në mënyrën e vdekjes së tyre. Tregohet për një djalë të ri i cili ishte shumë i paturpshëm, madje nga haramet nuk e largonte as turpi nga njerëzit. Shpesh kur kalonin besimtarët rreth shtëpisë së tij dhe kur e takonin me shoqërinë e tij e këshillonin pasi që shpesh e takonin duke polemizuar në çështje të kota dhe duke e humbur kohën në biseda. U thonin shpesh:

- O djem, Allahut ia keni borxh namazin, faleni namazin më së paku, pastaj veproni çfarë të doni. – me shpresë ti mëshiron Allahu dhe ti udhëzon. Porse asnjëherë nuk ju përgjigjen ftesës. Më vonë na treguan se ai grup djemsh kishin vendosur të shkojnë në udhëtim në disa shtete joislame. Duke e ditur qëllimin se pse duan të shkojnë atje, shkuan vëllezërit përsëri ti këshillonin. Porse nxitjet e shejtanit ishin më bindëse se sa fjalët e këshilluesve, sikur ai kishte dalë fitimtarë me ta, duke ua zbukuruar veprat e ulëta në të cilat kishin rënë dhe nuk kishte kthim prapa, pikërisht ashtu siç e ka thënë edhe Allahu në Kur'anin famëlartë. Pasi shkuan, nuk kaloi shumë kohë u kthyen për një arsye të veçantë! U kthyen duke e bartur me vete xhenazen e shokut të tyre për të cilin flisnim. Çfarë kishte ndodhur?! Një natë pasi ishin dëfryes në mëkate dhe harame, shokut të tyre i kishte rënë infarkt në zemër dhe për shpejt kohë në spital kishte ndëruar jetë. Kur shkuan ishin shumë të gëzuar dhe të lumtur por kur u kthyen ishin të mërzhitur dhe të pikëlluar se e humbën shokun e tyre.

A thua vallë ky djalë i ri kishte menduar se ky mund të jetë udhëtimi i tij i fundit? Pas gjithë kësaj që ndodhi një ditë unë vetë shkova tek varri i tij dhe i përkujtoja këshillat që ia kishin bërë vëllezërit këtij personi, sa shpesh e kishin takuar dhe e kishin këshilluar porse pa përgjigje pozitive nga ai. Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Thash me vete: Sikur të kishte shkuar ky djalosh në luftë në rrugë të Allahut dhe të ktheheshte i varur, pa dyshim do ishim gëzuar të gjithë, madje do lakmonim një vdekje të tillë, sikur të na kishte ardhur i vdekur prej ndonjë vendi ku ka shkuar për të kërkuar mjekim pas që ka qenë i sëmurë, do të ishim mërzhitur për të, apo edhe të kishte shkuar në ndonjë vend për studime dhe për të nxënë dije nga dijet e kësaj botë do të mbureshim me të, porse kjo lloj vdekje e tij ishte më e keqe e mundshme dhe më pak që dëshironim ta ndëgjonim.

Robër të Allahut: Këni frikë Allahun, sepse sa e sa të jetojmë jeta është e shkurtër, madje edhe sa e sa të përjetoj robi nga kjo botë ajo është e pavlerë, prandaj të mundohemi ta përkujtojmë sa më shpesh vdekjen, ajo e cila do ta ndihmoj ta përmirësojmë vetveten. Ti vizitojmë varetat sepse ato na përkujtojnë më së miri vdekjen, të prezantojnë në ndejat e dhikrit sepse ato na e zbusin zemrën. Mos haro vëlla i dashur kur të të ngurtësohet zemra përkujtoje Allahun, botën tjetër, vdekjen dhe përfundimin tënd, thotë Allahu në Kur'an:” **O ju që këni besuar keni frikë Allahun dhe le të shikoj secili prej jush se çfarë ka përgatitur për nesër, kini frikë Allahun sepse Allahu me të vërtetë e din se çfarë punoni, e mos u bëni si ata të cilët e haruan Allahun, e Allahu e bëri që ata ta harojnë vetveten, mu këta janë të prishurit.**”(Hashr:18-19)

O Allah o Zoti ynë, na e bën jetën tona më të mirë se ajo që kaloj, na e bëj që veprat tona të fundit të jenë më të mirat nga gjithë veprat tona, na i bën ditët më të mira ditët kur do të të takojmë Ty. O Allah na i zgjatë jetët tona, na i përmirëso veprat tona, na mundëso të vdesim më pendim të sinqertë, si dëshmorët e tu, na mëshiro pas vdekjes tonë o Zot i botrave. Ska Zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Allahut, më Fisniku më i Mëshirshmi Ti je o Zoti ynë, oti i arshit të madh, Zoti i qiejve dhe i tokës.

La ilahe il-Allah ne me këtë fjalë jetojmë, me këtë fjalë duam të të takojmë Ty o Allah dhe të lutemi na e bën këtë fjalë të fundit në jetën tonë. O Allah na e lehtëso vdekjen dhe agoninë e saj, jetën në var dhe terin e saj, si edhe nga pyetjet e vështira në të. Na mbroj nga

shtrëngimi në të, nga frika e ditës së ringjalljes. O Allah vepro me ne me mëshirën Tënde sepse ti je Falës, na i fal mëkatet tona, lëshimet tona, na i përforco këmbët tona dhe na ndihmo neve ndaj jobesimtarëve. Na jep siguri ë vendet tona, na i përmirëso udhëheqësit tonë, na i pajto gjithë muslimanëve në një rrjeshtë, na i përmirëso raportet e njëri tjetrit, na ndihmo o i Gjithëmëshirshëm, më Krenari më i Larti.

Kërkojmë prej Allahut falje, salavatet dhe selamet qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamedin, shokët e tij, familjen e tij në përgjithsi.

Pergatiti dhe pershtati: Nexhat Ceka